



Ambasada
e Republikës Federale të Gjermanisë
Tiranë



deutscher oktober
tetori gjerman

Javët gjermane në Shqipëri 2018

Thirrje për sponsorizim



deutscher oktober
tetori gjerman

Ambasada Gjermane në Tiranë
Rruga Skenderbej 8
Tel. 00355 4 2274 505

Retrospektivë

Një „**Faleminderit shumë!**“ duhet thënë edhe këtë vit që në fillim të kësaj thirrjeje për sponsorizim të Tetorit Gjerman. Fakti që ne kemi mundur të ngremë një traditë të javëve të kulturës gjermane në Shqipëri duke i ofruar publikut për çdo vit një program të larmishëm dhe ambicioz, ka qenë e mundur të realizohet vetëm falë bashkëpunimit të mirë dhe mbështetjes së sponsorizuesve tanë. **Për këtë përziemërisht faleminderit!**

Tetori Gjerman 2017 është zhvilluar nën moton „30 vjet rivendosje e marrëdhënieve diplomatike mes Gjermanisë dhe Shqipërisë“ dhe reflektoi gjithë diapazonin dhe dinamikën e marrëdhënieve dypalëshe mes vendeve tona. Me shfaqjet kulturore në teatër, kërcim, letërsi, film dhe muzikë kemi mundur edhe vitin e shkuar të gëzojmë spektatorë të shumtë, t'i nxisim të reflektojnë e të frymëzohen për diskutime të ndryshme rreth temash politike, ekonomike dhe shoqërore. Përjetimet e përbashkëta dhe shkëmbimi i mendimeve e përvojave mes gjermanëve dhe shqiptarëve ishte edhe këtë herë ideja qendrore dhe elementi lidhës i Tetorit Gjerman.



Tetori Gjerman 2018

Edhe në vitin e dymbëdhjetë të ekzistencës së tij ne dëshirojmë t'i qëndrojmë traditës së bukur të Tetorit Gjerman. Sërish do të përpiqemi të realizojmë ide të reja dhe të synojmë grupe të reja për të zgjuar tek ata interesin për Gjermaninë dhe kulturën gjermane. Ne dëshirojmë, që përmes punës sonë të krijojmë hapësirë për forcën krijuese dhe shijimin e artit, të mbështesim dialogun mes gjermanëve dhe shqiptarëve duke ngritur kësisoj ura lidhëse mes popujve tanë. Ndaj fokusi i aktiviteteve tona do të jetë edhe këtë vit ndër të tjera dhënia e impulseve brezit të ri në Shqipëri dhe nxitja e shkëmbimeve. Në këtë kontekst të gjitha projektet kulturore, sikurse janë punëtoritë, diskutimet apo projektet e realizuara bashkarisht, do të mbartin edhe komponentin e edukimit.

Tetori Gjerman nuk është një përsëritje: për çdo vit ne tregojmë aspekte të tjera të marrëdhënieve gjermano-shqiptare dhe realizojmë projekte të reja interesante në vende të ndryshme në Shqipëri.

Disa prej ideve tona për vitin 2018

- Tetori Gjerman sjell muzikë klasike edhe në 2018-ën. Është planifikuar, që të ftohet një trio e famshme pianoje në një shfaqje koncertore, ndjekur kjo prej një kursi me muzikë dhome. Po kështu edhe në Ambasadë do të jepet sërish një koncert me muzikë klasike.
- Kërcimi dhe teatri do të na gëzojnë sërish në vitin 2018. Qendra Goethe ka planifikuar një projekt kërcimi kontemporan me koreografin shqiptar Gjergj Prevazi. Ambasada Gjermane, në bashkëpunim me Ambasadën Franceze, dëshiron të sjellë në skenë një projekt teatror dhe diskutime me të rinj mbi temën e luftës dhe pajtimit - nisur kjo edhe nga 100-vjetori i fundit të Luftës së Parë Botërore.
- Në fushën e letërsisë do të kemi dy aktivitete tejet interesante: në program parashikohet një rezidencë letrare e autores Sandra Hoffmann, në kuadër të festivalit ndërkombëtar të poezisë dhe letërsisë "Poeteka" si dhe një mbrëmje leximi, muzike dhe diskutimesh me këngëtare gjermane Fatime Kosumi.
- Ndërsa në një projekt të planifikuar rreth temës së gatimit, kuzhinës dhe traditës 'Gourmet' do të hynë në lojë shqisat. Kuzhinierë të famshëm gjermanë dhe shqiptarë do të na prezantojnë të fshehtat shpesh të panjohura të gatimeve tradicionale të të dyja vendeve tona.
- Formate të ndryshme aktiviteteve do të kenë sërish për temë aktualitetin politik dhe shoqëror. Kështu në bashkëpunim me partnerët tanë kemi planifikuar konferenca dhe aktivitete lidhur me procesin e Berlinit, trajtimit të të shkuarës dhe Fake News.

Këta janë vetëm disa shembuj nga gjithë sa kemi planifikuar. Ashtu si në vitet paraardhëse një pjesë e aktiviteteve do të organizohet nga vetë Ambasada

Gjermane, të tjera nga institucionet tona partnere, por të gjitha do të koordinohen nga Sektori i Kulturës së Ambasadës Gjermane.

Pse të bëheni sponsor?

- Duke qenë sponsor ju mundësoni vijimin e traditës së Tetorit Gjerman dhe përfitoni prej imazhit të tij pozitiv si një aktivitet gjithëpërfshirës, por edhe prej aktiviteteve të veçanta të shumta, sikurse edhe prej emrit të mirë të Gjermanisë në Shqipëri.
- Ju shfrytëzoni si sipërmarrje gjermane ose gjermano-shqiptare opinionin pozitiv të publikut shqiptar përkundrejt Gjermanisë, produkteve dhe markave gjermane dhe kontribuoni në këtë aspekt me imazhin tuaj të mirë.
- Ne organizojmë aktivitete, të cilat bëhen temë bisedash e zgjojnë interes të madh në media dhe publik; zhvillojmë një punë aktive dhe profesionale me shtypin në formën e konferencave për shtyp, intervistave dhe materialeve promovuese shumëgjuhëshe. Përmes angazhimit të mediave sociale dhe atyre të partnerëve tanë arrijmë të përfshijmë grupmosha të tjera më të reja.
- Ambasada Gjermane në rolin e saj si koordinatore e përgjithshme e Tetorit Gjerman mbështet cilësinë dhe transparencën e të gjitha aktiviteteve!

Çfarë përfitoni ju si sponsor prej gjithë kësaj?

Nëse vendosni të mbështesni Tetorin Gjerman 2018, do të përfitoni

- paraqitjen e emrit dhe logos së firmës në të gjitha publikimet rreth Tetorit Gjerman dhe në faqen e internetit të Ambasadës Gjermane
- përmendjen e emrit tuaj si sponsor nga ana e Ambasadores gjatë konferencës për shtyp me rastin e çeljes së Tetorit Gjerman
- ftesa në të gjitha aktivitetet e Tetorit Gjerman

Në të shkuarën kontributet e sponsorizuesve tanë në vlerën nga 500,- deri në 5000,- euro na kanë ndihmuar shumë. Në publikimet e Tetorit Gjerman, në varësi të shumës së sponsorizimit do të ndërmerret edhe evidentimi grafik përkatës.

Ju lutemi të na kontaktoni deri me datë 16.03.!

Nëse jeni të interesuar për sponsorizimin atëherë na kontaktoni. Për të lehtësuar planifikimin tonë lutemi për një përgjigje **deri me datë 16.03.2018**.

Z. Dr. Johannes Dietrich Drejtues i Sektorit të Kulturës dhe Shtypit E-Mail: ku-1@tira.diplo.de	Z. Artan Begolli Sektori i Kulturës E-Mail: ku-100@tira.diplo.de	Z. Jürgen Lubczyk Sektori i Kulturës E-Mail: ku-10@tira.diplo.de
---	---	--